



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:058788
Datë: 19.04.2022
Numri i dokumentit: 02930011

AA.nr.280/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj kryetar, Delushe Halimi dhe Ramiz Kuqi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit - propozuesit Gramoz Vokri nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson zyra ligjore Pro Juris Law Firm, me seli në Prishtinë, rr. "Hajdar Dushi", kundër të paditurës "Federata e Futbollit të Kosovës" me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, me propozim për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.740/2022, të datës 29.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit -propozuesit Gramoz Vokri nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative A.nr.740/22, i datës 29.03.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar A.nr.740/22, të datës 29.03.2022, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo-kompetente në këtë çështje administrative dhe pas plotfuqishmërisë së aktvendimit lënda t'i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Civil.

Kundër këtij aktvendimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të: shkeljes të dispozitave ligjore; konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditësit kundër-propozuesit si të bazuar, dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.740/22 i datës 29.03.2022, dhe çështja të kthehet në kompetencë të këtij Departamenti.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e paditësit-propozuesit është **e pa-bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi- propozuesi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datën 28.03.2022, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit -aktit administrativ të paditurës nr. 1042/1 të datës 22.03.2022 dhe bashkë me padi ka paraqitur propozim për vendosjen e masës së përkohshme të sigurisë - shtyrje të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë me aktvendimin A.nr.740/22, të datës 29.03.2022, është shpallur jo-kompetente për të vendosur në këtë çështje administrative. Në arsyetim të aktvendimit është konstatuar se e paditura “Federata e Futbollit të Kosovës” është organizatë joqeveritare jo profitabile, fushë-veprimtaria e saj rregullohet me Rregulloret e Brendshme dhe ka Statutin e saj të punës dhe se akti i goditur me padi nuk është akt administrativ i nxjerrë nga organi shtetëror që ushtron autorizime publike, dhe si i tillë paditësi mbrojtjen gjyqësore mund të zhvillohet në procedurën gjyqësore kontestimore.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar më ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK në lidhje me nenin 63 të LKA -së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, në lidhje me nenin 63 të LKA -së.

Sipas dispozitës së nenit 15, paragrafi 1 pika 1.1 është përcaktuar që *“konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve të nxjerra në çështjet në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”*

Andaj, mbi këtë bazë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditësit se në bazë të nenit 19 të LKA -së, është përcaktuar se pësoni fizik që është anëtarë o ndonjë organizate joqeveritare, e cila sipas rregullave e veta ka ë detyrë të mbrojtë të drejtat dhe interesat të caktuara të anëtarëve të vet, nëse me akt administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes i tillë, kjo organizatë mundet me pëlqimin e anëtarit të vet në emër të tij të paraqes padinë dhe të zhvilloj konfliktin administrativ, dhe se vendimi i të paditurës është akt administrativ.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit vlerëson se e drejta e anëtarit të organizatës joqeveritare për të parashtruar padi në mbrojtje të anëtarit të saj, në emër të tij mund të jetësohet në raport me vendimet e organeve shtetërore kur këto vendime prekin interesin e organizatës apo të anëtarit të saj, por jo në rastin konkret ku paditës është personi fizik anëtari i organizatës i cili ka parashtruar padi kundër vendimit të organizatës së tij, e jo e kundërta organizata në emër të tij, në raport me vendimet e organeve tjera shtetërore.

Në rastin konkret gjykata ankimore ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë përfundimin e **tërë kësaj procedure** e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në vendimin e saj për t'u shpallë jokom-petente në këtë çështje administrative.

Përfundimisht, Gjkata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 209 par. 1 pika (b) e LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.280/22, datë 19.04.2022



Kryetari i kolegjit- Gjyqtari,
Mehmet Ndrecaj